



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

GRUPI I PUNËS

Adresa: Lagja Kastriot, Rruga Ramiz Aranitasi Nr.15, Fier, Shqipëri / www.bashkiafier.gov.al/ tel.: +355 34.410 636

Nr. 1475 Prot.

Fier, më 16 . 02 .2023

Miratohet
KRYETARI I BASHKISË

Armando SUBASHI



TERMA REFERENCE

PËR KONKURSIN:

“Konkurs për ideimin, krijimin dhe zbatimin e Veprës së Artit që do të vendoset në sheshin Europa Piazza, Fier”



Në mbështetje të udhërit të brendshëm të kryetarit të Bashkisë, Nr. Prot. 510, datë 19.01.2023 "Për përcaktimin e termave të referencës për objektin e prokurimit "Konkursi për Ideimin dhe Zbatimin e Veprës së Artit që do të vendoset në sheshin Europa Piazza, Fier"

01.1. Përfitues

Bashkia Fier

01.2. Hyrje - (Historiku mbi qytetin e Fierit)

Qyteti i Fierit është një nga qytetet më të rëndësishme të Shqipërisë me kontribute të theksuara në fusha të ndryshme të jetës, i cili mbart në vetvete një histori të re krahasuar me qytetet fqinjë, si Berati dhe Vlora. Ai duhet të jetë krijuar pas vitit 1690 pas pushtimit të Vlorës nga Venediku kur sanxhakbeu Kapllan Mehmet Pasha e shpërnguli selinë e tij në Berat. Kështu, përgjatë rrugës së komunikimit midis qendrës së re të sanxhakut, Beratit dhe qytetit të Vlorës, duhej një stacion i ri i cili nisi funksionimin e tij. Ky vendqëndrim i udhëtarëve dhe karvaneve lindi pikërisht në vendin e quajtur Fier ku bëhej kalimi mbi lumin Gjanica. Ndërkohë zhvillimin e tij Fieri e mori në kohën e sundimit të sanxhakbeut të Beratit Ahmet Kurt Pashës (1768-1789), i cili në vitin 1777 ngriti urën mbi lumin Gjanica. Duke parë perspektivën e zhvillimit të këtij vendbanimi, Kisha Ortodokse, ndërtoi pranë urës së Gjanicës në vitin 1782 kishën e Shën Gjergjit, një nga katedralet më të mëdha të krahinës së Myzeqesë. Shndërrimi i Fierit si qytet nis rreth gjysmës së shek. XVIII, kur Kahreman Pashë Vrioni, u shkëput nga Berati dhe u vendos në Fier, të cilin e kishte marrë më parë si çiflig me qira nga shteti. Në 29 korrik 1864, ai e bleu atë nga thesari perandorak për shumën 150 000 grosh. Nën drejtimin e tij, Fieri, do të shndërrohej në qendër të rajonit si një vendkalim i rëndësishëm ku kryqëzoheshin rrugët Berat-Vlorë, Vlorë-Lushnje dhe Mallakastër-Skela e Semanit. Kështu me rëndësinë që fitoi si qendër kalimi dhe e transportit, Fieri, nisi të ndryshonte edhe fizionominë e tij. Ai do të shndërrohet gradualisht nga një vendbanim i karakterit rural në një qendër tregtie, zejtarie dhe shërbimesh. Veprimtaria kryesore ekonomike e tij do të ishte tregtimi i prodhimeve bujqësore të Myzeqesë, Mallakastrës dhe krahinave përreth. Në përputhje me kushtet natyrore projektua edhe hapësira e tij urbane ku, qyteti shtrihej në krahun majtë të shtratit të lumit Gjanica, sipas një plani ku kombinohej sistemi rrugor rrezor me atë kuadratik. Ndërsa në të dy anët e rrugës së tij kryesore u ngritën ndërtesa dykatëshe me arkitekturë të stilit neoklasik. Pranë kësaj rruge ndodhej edhe tregu si dhe ndërtesat kryesore administrative. Ndërkohë që një impuls të ri rritjes dhe zhvillimit të shpejtë të qytetit i dha i biri i Kahreman Pashës, Omer Pashë Vrioni. Rreth kësaj teme na japin të dhëna autorë të ndryshëm. Kështu, Teki Selenica shkruan rreth saj se: "Në vitin 1877 Fieri u rindërtua dhe u sistemua sipas një plani modern nga Omer Pasha". Ndërsa për paraqitjen e këtij plani, Eqrem Bej Vlora i cili kishte vizituar shumë herë Fierin midis fundit dhe fillimit të shek. XIX-XX, e përcaktonte atë si: "Thuajse një qytet perëndimor". Po kështu, udhëtarja angleze Edit Durham e cila e vizitoi Fierin në vitin 1904, na ka lënë këtë dëshmi: "Fieri është një fshat i vogël, pronë e një beu me shumë iniciativë, i cili ka ndërmend ta kthejë në një qendër tregtare. Ai ka rindërtuar pazarin, ka ngritur godina solide prej guri me një arkitekturë çuditërisht moderne". Në fillim të shek. XX, qyteti përbëhej nga pesë lagje si: Pasha, Belik, Kishë, Bishanak dhe Shkozë. Vetëm në vitet 1920 nisi rritja dhe zgjerimi i Fierit ku atij ju shtuan edhe dy lagje të reja: "Liri" dhe "Kastriot". Ndërkohë që statusin e një qyteti të madh dhe të rëndësishëm Fieri do ta merrte pas Çlirimit. Në saj të zhvillimit të bujqësisë dhe të disa degëve të industries, ai do të shndërrohej në një qendër të madhe urbane dhe në një nga qytetet më të mëdha dhe të rëndësishme të Shqipërisë.

Ndërkohë le të kthehemi tek problemi, historia e sheshit kryesor dhe më të vjetër të Fierit, njëkohësisht edhe qendra dhe bërthama e tij. Dikur ky shesh ishte pika e hyrjes dhe e daljes nga qyteti, qendra ku kryqëzoheshin katër rrugët kryesore të Fierit, piknisja e komunikimit rrugor. Por gjatë shek. XX, ky shesh, do të shndërrohej



në vendin ku do të zhvilloheshin disa nga ngjarjet kryesore të zhvillimeve historike. Në lidhje me të po rendisim disa fakte dhe ngjarje të ndodhura në kohë të ndryshme pikerisht në këtë vend.

1-Në antikitet në këtë vend kalonte dega jugore e rrugës Egnatia. Ajo pasi dilte nga qyteti antik I Apolonisë, mbërrinte në Fier dhe pasi kalonte lumin Gjanica, vijonte rrugën drejt luginës së lumit Shkumbin ku takohej me degën veriore të Egnatias që vinte nga Durrësi (Dyrrahu). Dihet që rruga Egnatia ishte një nga arteriet kryesore të komunikimit në Perandorinë Romake, e cila lidhte perëndimin me lindjen, Romën me Kostandinopojën.

2-Pranë saj në vitin 1777 u ndërtua Ura e Gjanicës e cila e shndërroi Fierit në një qendër-stacion të rrugës Berat-Vlorë, që u bë edhe bërthama e krijimit të qytetit të ardhshëm.

3-Në periudhën moderne në vitin 1912, Fieri, do të ishte edhe stacioni i fundit udhëtimit të Ismail Qemalit për shpalljen e pavarësisë. Prej këtij sheshi ai doli nga qyteti i Fierit i shoqëtuar nga populli dhe u nis drejt Vlorës për të realizuar pavarësinë. Pikerisht këtu në 29 nëntor 1912, patriotët dhe populli i Fierit nën drejtimin e kryetarit të bashkisë Tonç Kilica, ngritën flamurin dhe shpallën mbështetjen ndaj vendimeve të Kuvendit të Vlorës.

4-Një tjetër ngjarje tjetër që do të zhvillohej në këtë shesh ishte edhe Lëvizja e Fierit e 14 gushtit 1935. Ajo ishte revolta më serioze kundër monarkisë ngjarja që e bëri të njohur Fierin në Evropë dhe në opinionin publik ndërkombëtar.

4-Po kështu, gjatë viteve të L. II. Botërore ky shesh do të bëhej vend i zhvillimeve të rëndësishme politike dhe ushtarake. Prej tij u futën në qytet njësitë partizane që çliruan Fierin në 15 tetor 1944.

5-Ndërkohë që në këtë shesh, në 20 shkurt të vitit 1991, dhjetra qytetarë fierakë u ngritën dhe demonstruan duke rrëzuar bustin e Enver Hoxhës si simbol të regjimit komunist, në të njëjtën ditë me shembjen e tij në Tiranë.

6-Ndërkohë duke nisur nga viti 1999 dhe deri disa vite më parë, në këtë shesh janë vendosur disa memoriale, buste, pllakate dhe monumente që përkujtojnë ngjarjet kryesore historike, si Shpalljen e Pavarësisë, Çlirimin e Fierit, 68 Vajzat Partizane, Herojnë e Popullit Liri Gero. Një prej këtyre monumenteve ka qenë edhe instalacioni i Globit. Ai u vendos në sheshin në fjalë, i cili u quajt "Europa Piazza" në vitin 2012, si simbol i mikpritjes (Fieri njihet si qyteti ku jetojnë në harmoni komunitete krahinore nga gjithë vendi) edhe perspektivës europiane të Shqipërisë. Për arsye rrezikun dhe sigurie teknike ai u çmontua dhe u hoq nga rrethrotullimi I këtij sheshi. Tashmë në lidhje me të pritet realizimi i projektit të ri.

* Qendra historike e qytetit të Fierit, vendi i quajtur rrethrotullimi mban emrin "Europa

Plazza"

02

OBJEKTIVI DHE QËLLIMI

02.1. Objektivi

Nëpërmjet këtij projekti synohet të perfundohet rikualifikimi i qendrës duke krijuar një hapsirë të re, me fokus krijimin e një identiteti autentik dhe hapjen e një dimensionit të ri bashkëkohor. Nëpërmjet këtij projekti synohet afrimi i qytetareve me artin kulturen dhe krijimi i një imazhi të ri për sheshin Europa Piazza në qytetin e Fierit pra një "Qasje artistike e vepres në kontekstin e zhvillimeve historike të qytetit".



II. OBJEKTIVAT KRYESORË

- a. Forcimi i rolit dhe rëndësisë së kulturës në zhvillimin kombëtar si një forcë dinamike, sfiduese, e lirë dhe pavarur, bazuar në lirinë e shprehjes.
- b. Promovimi i një trashëgimie publike të gjallë artistike, të aksesueshme, e cila konservohet, përdoret dhe zhvillohet.
- c. Promovimi dhe forcimi i rolit të artistit në shoqërinë shqiptare, në qëndrimin kritik dhe përfshirjen e publikut mbi cilësinë estetike dhe ndjesore, në ridimensionimin e mendimit të publikut mbi shprehjen artistike, si dhe në analizën e fenomeneve që përfshijnë shoqërinë mbi vlerat kulturore dhe marrëdhënies ndërmjet nesh dhe botës.
- d. Promovimi i diversitetit dhe cilësisë artistike në vendin tonë, si shprehje e zhvillimit të shoqërisë.
- e. Mbështetje e skenës artistike.
- f. Promovimi i artit bashkëkohor publik, duke i kushtuar një vëmendje të posaçme të drejtës për kulturë të shoqërisë, të fëmijëve dhe të rinjve.
- g. Forcimi i identitetit lokal, nëpërmjet politikave të kulturës.
- h. Identifikimi i hapësirave publike, nëpërmjet artit, duke impaktuar tërheqjen turistike dhe rrjedhojë ekonomike lokale.
- i. Zhvillimi ekonomik i zonës dhe rajonit përreth.
- j. Promovimi i qytetit të Fierit në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare, nëpërmjet artit bashkëkohor në hapësirat publike.

Objektivat e këtij shërbimi janë:

1. Të nxisë dhe rigjenerojë zonën e projektit, duke kontribuar në përmirësimin e qendrës së qytetit të Fierit përmes rijetëzimit të saj.
2. Të angazhojë artiste të qytetit ose me gjere të lenë gjurme në këte qytet.
3. Të afrojë qytetarin me veprat artistike dhe artin në një kontekst me të gjere.

02.3. Qëllimi

Ky konkurs ka për qëllim pikërisht promovimin e artit pamor në hapësirat e përbashkëta publike. Nxitjen e brezave të rinj për t'u zhvilluar më tepër në këtë drejtim si dhe edukimin e publikut të gjerë me vepra të artit.

Ky konkurs synon përfitimin e një projekti estetik, pra të një veprë artistike, me qëllim përfshirjen e artit në hapësirën publike si një mënyrë për ta bërë artin pjesë të rëndësishme të jetës së përditshme të komunitetit.

Vepra e artit në hapësirë publike është një shprehje e rëndësishme dhe e pamohueshme e zhvillimit njerëzor në habitatin e tij. Ajo krijon qartazi një memorie të përbashkët kulturore e cila diskutohet, ndahet, përjetohet dhe trashëgohet dhe shërben si pikë referimi për identitetin e qytetit apo lokalitetit në të cilin ngrihet. Shpesh në përmasa të mëdha ajo konfirmon dëshirën njerëzore dhe të komunitetit për të pasur një raport të drejtpërdrejtë me veprën e artit në publik, përtej muzeut dhe jashtë tij.

Arti në hapësirë publike luan një rol të fuqishëm në tërheqjen jo vetëm të turizmit kulturor, por edhe në tërheqjen e investitorëve publikë ose privatë, vendas apo të huaj, duke u përpjekur të harmonizojë bërthamën sociale dhe kulturore të atij vendi me zhvillimin ekonomik të tij. Efekti transformues i artit është i fuqishëm përmes përballjes me të në vendndodhje dhe terrene ku priten më së paku të haset, në vende të papritura, të befta dhe jashtë klisheve të muzeut dhe vendeve ku njerëzit janë mësuar ta shohin tradicionalisht. Po ashtu edhe fuqia e tij në të tilla vende transmetohet drejtpërdrejtë.



Vendndodhja e krijimit dhe zbatimin e Veprës së Artit që do të vendoset është sheshin Europa Piazza, Fier
Bashkangjitur termave te references do te jete dhe plani i pergjithshem vendore(PPV) i sheshit Europa
Piazza(faqe 1 2) ,foto(foto 6-11),plan vendosja(foto 3),gjendja ekzistuese(foto 4),ortofoto(foto 5) etj.

03

KONKURS PROJEKTIMI

“Konkurs për ideimin, krijimin dhe zbatimin e Veprës së Artit që do të vendoset në sheshin Europa, Fier”, procedurë prokurimi me 2 (dy) faza ne forme shkresore.

– Faza 1 dhe Faza 2 (fazat nga dorezimi i kerkesave per shprehje interesi e ne vijim) bazuar në VKM nr.384 datë 30.06.2021 “Per formen e komunikimit ne procedurat e prokurimit publik” i ndryshuar , me VKM nr.22 date 18.01.2023 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne vendimin nr.384 date 30.06.2021 “Per formen e komunikimit ne procedurat e prokurimit publik”, zhvillohen ne forme shkresore pranë ambjenteve të Bashkisë Fier, Fier, Shqipëri.

Baza Ligjore: Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, V.K.M. nr.285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit Bashkiak Fier nr.122 datë 14.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2023”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier sipas shkresës zyrtare nr.1314/1 datë 28.12.2022.

Qëllimi i Konkursit të Projektimit: Ky Konkurs projektimi organizohet si pjesë e një procedure, që shërben për përcaktimin e një fituesi të një kontrate shërbimi publik (pika 2, neni 57 i V.K.M. nr.285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar).

Autoriteti kontraktor Bashkia Fier, duke qënë në rastin e parashikuar nga shkronja ‘b’, e pikës 2, të nenit 57 të të V.K.M. nr.285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, kur autoriteti kontraktor organizon konkurs projektimi, si pjesë të një procedure që çon në përzgjedhjen e kontratës fituese për shërbime, do të përdorë procedurën me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit për kryerjen e shërbimit me kandidatin fitues, të suksesshëm të dalë në përfundim të konkursit të projektimit, në përputhje me pikën 3, të nenit 47, të LPP-së.

Bazuar edhe në nenin 47 të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, do të zhvillojë procedurën me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit për kryerjen e shërbimit me kandidatin fitues të Konkursit, me anë të së cilës do të kryejë të gjitha procedurat negociuese, për të gjitha elementët e Kontratës së shërbimit të zbatimit të veprës artistike.

I. Kërkesat për Kualifikim për Fazën 1 të Konkursit

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMI

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Inkurajohen të aplikojnë artistë të arteve pamore, si dhe profesionistë të lirë (arkitektë dhe designers), të cilët kanë një profil të qartë profesional, eksperiencia të ngjashme artistike, pjesëmarrje në ekspozita publike, bashkëkohore dhe të artit publik, si dhe përvojë në krijimin e veprave të mëdha, të përhershme dhe në shkallë urbane. Pranimi i pjesëmarrësve në konkurset e projektimit nuk do të kufizohet për shkak të shtetësisë, territorit ose rezidencës apo për shkak të qënies person fizik ose juridik.

2.1.1. Kandidati/ët do të dorëzojnë kërkesën për shprehje interesi, sipas Shtojcës 1.

2.1.2. Artistët duhet të kenë ushtruar profesionin e tyre sipas përkatësisë profesionale. Per kete kandidati/ët duhet të paraqesin Portofolin e artistitit/grupit të artistëve, ku përfshihet jetëshkrimi i artistit/ve (CV më të dhëna për formimin profesional, deshmi kualifikimi, veprimtarinë artistike, punimet artistike, arritjet, etj.).

2.1.3. Kandidati/ët duhet të paraqesin nje vetedeklarate se punimi i propozuar per kete konkurs projektimi (vepra artistike qe do te prezantojne ne kete konkurs projektimi) eshte origjinale dhe e pa publikuar me pare dhe se autori/ët mban pergjegjesi ligjore per autencitetin e tyre para ligjit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Kandidati/ët duhet të paraqesin të paktën 2 (dy) punë të ngjashme të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Per kete pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese një nga dokumentat e meposhtem:

a- vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

ose

b- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2. Kandidati/ët duhet të paraqesin Projektidenë e veprës artistike, si dhe çdo material tjetër shoqëruese që vlerësojnë të arsyeshëm, në funksion të prezantimit të idesë së tyre, e cila duhet të përmbajë të paktën, por pa u limituar:

– Konceptin e projekt idesë

– Përshkrim i materialeve që do të përdoren për ndërtimin e veprës, ku të specifikohet rezistenca e tyre materiale.

– Planvendosje e veprës.

– Projekt ideja e sistemimit të mjedisit përreth (projekt ide konceptuale/projekt ide landscape).

– Vizualizimi i veprës duhet të prezantohet minimalisht me një nga këto mënyra paraqitjeje: (vizatime; renders; animacion, fotomontazh, apo dhe forma të tjera alternative prezantimi.)

– Hapat e realizimit dhe implementimit të veprës.

****Shënim:** Artistët mund të aplikojnë individualisht ose në grup.

II. Kërkesat për Fazën 2 të Konkursit – Paraqitja përpara Jurisë e Propozimit Teknik dhe Propozimit Ekonomik

(bazuar në shkronjën 'd', pika 5, neni 57 i i V.K.M. nr.285 datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, flesa për kandidatët e parakualifikuar në Fazën 1, shoqërohet me udhëzimet e nevojshme për ofertuesit, ku jepet i gjithë informacioni që do t'i ndihmonte për përgatitjen e propozimeve. Në këtë kuptim kërkesat e mëposhtëme por që nuk kufizohen, do të evidentohen edhe në ftesën për kandidatët e parakualifikuar)

II.1. Dokumentacioni administrativo-ligjor për dorëzim në Fazën 2 të Konkursit

Në funksion të kushteve të realizimit të një vepre publike, referuar objektit të këtij Konkursi, si dhe referuar propozimit të tyre artistik dhe realizimit dhe zbatimit të veprës artistike në terren, artistët duhet të përfshijnë në strukturën e tyre ekspertë dhe profesionistë, në kushtet e një ndërhyrjeje në ambiente publike.

Për sa më sipër Kandidatët në fazën 2 duhet të dorëzojnë:

II.1.1 Secili prej artistëve duhet të përfshijë nëpërmjet **Vetëdeklarimit në dokumentacionin e aplikimit**, përbërjen e grupit (ekipit), nga një grup ekspertësh profesionistë, specifikisht në kategoritë e poshtëshënuara por pa u limituar:

1– **Arkitekt:** Ka për qëllim, të analizoj situatën e kushteve kontekstuale, faktike dhe fizike, infrastrukturore, dhe ato të pejsazhit urban, faktorët e riskut në përmbajtje të nenit 23 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, sipas rekomandimeve të ARRSH-së, si dhe ndikimin ekologjik dhe social kulturor, në kushtet e ndërhyrjes urbane nëpërmjet veprës.

2– **Inxhinier Strukturist:** Ka për qëllim, të analizoj situatën e kushteve fizike dhe dinamike, gjeologjike dhe infrastrukturore, faktorët e riskut në përmbajtje të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, sipas rekomandimeve të ARRSH-së, si dhe të siguroj qëndrueshmërinë strukturore (statike) të veprës.

3– **Inxhinier Elektrik:** Ka për qëllim, të analizoj situatën e kushteve infrastrukturore elektrike, faktorët e riskut në përmbajtje të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, sipas rekomandimeve të ARRSH-së, në funksion të ndriçimit të veprës. *(nëse është e nevojshme, pra nëse aplikohet).*

4– **Inxhinier Hidroteknik:** *(nëse është e nevojshme, pra nëse aplikohet)* Ka për qëllim, të analizoj situatën e kushteve infrastrukturore hidroteknike, faktorët e riskut në përmbajtje të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, sipas rekomandimeve të ARRSH-së, në funksion të realizimit të veprës.

II.1.2 Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet partnerëve dhe bashkëpunëtorëve në krijimin artistik, si dhe me subjektin/tet, të cilët do të jetë përgjegjës për ndërtimin dhe sigurinë, si gjatë instalimit ashtu edhe pas saj, si më poshtë:

Marrëveshje të Bashkëpunimit ndërmjet:

- Artistit, me ekspert me titull "arkitekt";
- Artistit, me ekspert me titull "inxhinier ndërtimi/profili strukturist"
- Artistit, me ekspert me titull "inxhinier elektrik" (nëse aplikohet)
- Artistit, me ekspert me titull "inxhinier hidroteknik" (nëse aplikohet)
- Artistit, me një shoqëri të licencuar që ushtron veprimtari ndërtuese zbatimi

Në rastin e artistëve të huaj (nëse ka):

– Çdo ekip ndërkombëtar rekomandohet, për t'u lidhur në partneritet në aspektin mbështetës teknik dhe këshillues, me një partner/ekip, që ushtron aktivitetin në Republikën e Shqipërisë;

II.1.3 Artistët, duhet të paraqesin **një vetëdeklaratë** mbi të drejtën e autorit për projekt idenë dhe veprën e materializuar (bocetit) për aplikimin në konkurs, në përputhje me legjislacionin Shqipëtar në fuqi.

II.1.4 Artisti/ët e shpallur fitues përmes konkursit me objekt “**Konkurs për ideimin, krijimin dhe zbatimin e Veprës së Artit që do të vendoset në sheshin Europa Piazza, Fier**”. duhet të nënshkruajnë një dokument në të cilin të shprehet se transferon Bashkise Fier të drejtën e pronësisë së veprës artistike dhe materialit, në të cilën është mishëruar/fiksuar vepra, bazuar në ligjin me nr. 35/2016 “*Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to*”.

II.2. Dokumentacioni Tekniko-Ekonomik (Propozimi Teknik dhe Ekonomik) për prezantim në Fazën 2 të Konkursit

II.2.1. Artistët në fazën 2 të këtij Konkursi duhet të bashkëlidhin dhe prezantojnë, **Projektin Teknik të Zbatimit të Veprës (projektin inxhinierik ose arkitektonik për realizimin dhe ndërtimin e veprës)**, të hartuara në përputhje me legjislacionin në fuqi, ku ndër plotësimeve të sugjeruara artistike, duhet të përfshihen, por pa u limituar, të paktën:

- Projekt Arkitektonik / Plan vendosje e Veprës;
- Prezantimin e Bocetit të veprës artistike, bocet-maket, apo çdo formë tjetër prezantimi teknik.
- Projekt i sistemimit të mjedisit përreth (*Konceptimi i vepres ne harmoni dhe ne ansambël te plote me rreth rrotullimin*)
- Projekt Konstruktiv
- Projekt Elektrik, Hidroteknik (nëse është i nevojshëm, në varësi të propozimit dhe konceptit artistik)
- Përshkrimin e detajuar të fazave të realizimit të veprës artistike; Metodologjia e Zhvillimit të Veprës.
- Referencë teknike dhe këshillimore, mbi mirëmbajtjen e veprës në kohë, si dhe ndërhyrjeve në lidhje me restaurimin e mundshëm të saj, në vazhdim.
- Grafikon e realizimit dhe përfundimit të punimeve të veprës;
- Vlerën e Realizimit të Veprës në tërësi, të detajuar sipas Preventivit të përgjithshëm të punimeve, duke respektuar Manualin Teknik të Cmimeve sipas VKM Nr.629, datë 15.7.2015 “*PËR MIRATIMIN E MANUALEVE TEKNIKE TË ÇMIMEVE TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT DHE TË ANALIZAVE TEKNIKE TË TYRE*”, i ndryshuar, përfshirë shpërblimin për të drejtën e autorit mbi veprën artistike të krijuar;

II.2.2. Vetëdeklarimin për angazhimin e artistit, në realizimin dhe prodhimin/ndërtimin fizik të veprës artistike, deri në momentin e vendosjes së saj në hapësirën publike të miratuar;

II.2.3. Vetëdeklarimin e artistit për disponibilitetin e tyre për punimet e mirëmbajtjes së veprës artistike për një afat 2-vjeçar nga momenti i vendosjes së saj në hapësirën publike të miratuar, në rast dëmtimi për shkak të cilesise se vepres.

Shënim:

Ky Konkurs projektimi organizohet si pjesë e një procedure, që shërben për përcaktimin e një fituesi të një kontrate shërbimi publik (pika 2, neni 57 i V.K.M. nr.285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar).

Realizimi i punimeve të ndërtimit dhe instalimi i veprës, duhet të realizohet nga një shoqëri e e licencuar, e cila është përgjegjëse për ndërtimin dhe sigurinë, si gjatë instalimit ashtu edhe pas saj.

Për sa më sipër, autoriteti kontraktor Bashkia Fier, duke qënë në rastin e parashikuar nga shkronja ‘b’, e pikës 2, të nenit 57 të të V.K.M. nr.285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të

ndryshuar, kur autoriteti kontraktor organizon konkurs projektimi, si pjesë të një procedure që çon në përzgjedhjen e kontratës fituese për shërbime, do të përdorë procedurën me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit për kryerjen e shërbimit me kandidatin fitues, të suksesshëm të dalë në përfundim të konkursit të projektimit, në përputhje me pikën 3, të nenit 47, të I PP së

Bazuar në nenin 47 të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", autoriteti kontraktor do të zhvillojë procedurën me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit për kryerjen e shërbimit me kandidatin fitues të Konkursi, me anë të së cilës do të kryejë të gjitha procedurat negociuese, për të gjitha elementët e Kontratës së shërbimit të zbatimit të veprës artistike, si dhe do të kërkojë Kandidatit fitues (Artistit fitues) të shpallur për këtë Konkurs, që në procedurën me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit për kryerjen e shërbimit të zbatimit të veprës artistike, të paraqesë dhe të dorëzojë të gjithë dokumentacionin ligjor të kërkuar për ushtrimin e aktivitetit në këtë fushë, të shoqërisë së licencuar që ushtron veprimtari ndertuese zbatimi, me të cilën ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi, sipas deklarimeve në fazën 2 të procedurës Konkurs Projektimi.

III. KRITERET E VLERËSIMIT

III.1. Vlerësimi nga juria do të bazohet në këto kritere pikëzimi:

1. Projekt idetë bazuar në vlerësimin artistik të veprës në raport me Propozimin Teknik të Paraqitur (figura artistike, koncepti, niveli i krijimtarisë, etj.) – **60 pikë.**
2. Çmimi më i ulët i ofruar në përpjesëtim me cilësinë e projekt idesë. – **25 pikë.**
3. Portofolin e artistit/grupit të artistëve, ku përfshihet jetëshkrimi i artistit/ve (CV më të dhëna për formimin profesional, kualifikimet, veprimtarinë artistike, punimet artistike, arritjet, etj.). – **10 pikë.**
4. Afatin e realizimit të veprës sipas grafikut të paraqitur nga artisti pa devijuar nga propozimi. – **5 pikë.**

III.2. Në përfundim të renditjes sipas vlerësimit me pikë nga juria, bazuar në Ligjin nr.162/2020 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", në V.K.M. nr.285 datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, bazuar në Ligjin Nr.10352, datë 18.11.2010 "Për Artin dhe Kulturën" i ndryshuar me Ligj 25/2014, si dhe bazuar në standardet dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare, autoriteti kontraktor do të akordojë çmime vlerësuese në formën e shpërblimit artistik për cilësinë artistike të projekteve artistike të paraqitura, për fituesit e 3 (tre) vendeve të para, si më poshtë:

1. Masa e shpërblimit artistik për cilësinë artistike, për fituesin e vendit të parë (pra, për artistin/ët vepra e të cilëve do të përzgjidhet si vepra artistike fituese e konkursit dhe do të realizohet dhe zbatohet në terren, sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi), do të jete nenshkrimi i kontrates së shërbimit publik.

2. Masa e shpërblimit artistik për cilësinë artistike, për fituesin e vendit të dytë, do të jetë në vlerën **150 000 Lekë.**

3. Masa e shpërblimit artistik për cilësinë artistike, për fituesin e vendit të tretë, do të jetë në vlerën **100 000 Lekë**

IV. ARTISTI/ËT FITUES I REALIZIMIT TË VEPRËS ËSHTË PËRGJEGJËS PËR:

a. Realizimin dhe prodhimin fizik të veprës, sipas planit të parashikuar deri në vendosjen e saj në lokacionin e miratuar për vendosjen e monumentit/veprës.

b. Mban kontakte me përfaqësuesit e Bashkisë Fier mbi zhvillimin e realizimit të veprës, për t'u siguruar që procesi të ecë pa probleme deri në zbatimin e përfundimit të instalimit të veprës.

c. Realizimin e instalimit të veprës të përfunduar Brenda afatit të deklaruar.

d. Mirëmbajtjen e veprës artistike për një afat 2 (dy) vjeçar nga momenti i vendosjes së saj në sheshin e miratuar, duke raportuar pranë Bashkisë Fier, në rast dëmtimi për shkaqet e cilesise se vepres.(periudha e garancisë).

e. Raportimet periodike nga përfituesi me subjektin bashkëpunues që do të ndërtojë dhe instalojë veprën gjatë procesit të realizimit.

04

KERKESAT PER RAPORTIMET DHE DOREZIMET E SHËRBIMEVE

1. Kërkesat për raportimet gjatë fazës së projekt-propozimit

- Kërkojme konfirmimin e pjesmarjes tuaj ne konkurs si edhe dosjen tuaj artistike dhe dokumentacionin e kerkuar me larte si dhe metodologjine që do të përdoret për të ndërmarrë kryerjen e shërbimeve, duke përfshirë një plan të detajuar zbatimi (projekt dhe preventiv).
- Bazuar në progresin e punës, do të mbahen 1 ose 2 dëgjesa publike gjatë fazës së hartimit dhe detajimit të projekt-propozimit, për të diskutuar çdo çështje tjetër të hasur gjatë punës. Në përfundim të tyre do të mbahen raporte të nënshkruara nga Bashkia dhe juria artistike e vendosur për vleresimin e veprave (fituesi do të përcaktohet nga një juri artistike me personalitete të artit dhe kultures). Raportet do të detajojnë aktivitetin, duke përfshirë çdo çështje, së bashku me çdo informacion tjetër të nevojshëm, për të garantuar transparencë dhe qëndrueshmëri të projektit.
- Pas çdo dëgjese dhe kthimit të draft raportit me vërejtje nga Autoriteti Kontraktues do të përgatitet dhe dorëzohet në rrugë zyrtare pranë Autoritetit Kontraktues, projektin e plotë përfundimtar së bashku me Raportin Përfundimtar, Preventivin përfundimtar dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm.
- Punimi final sipas kërkesave të përcaktuara, do të dërgohen Autoritetit Kontraktues sapo të përgatiten, por jo më vonë se 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës së zbatimit në terren të vepres mbas procedurës së negociimit. Dorëzimi i projektit (do të jetë objekti artistik i punuar në shkallën e caktuar nga artisti dhe në materialin përfundimtar që do të zbatohet në objekt) do të bëhet në rrugë zyrtare cili do të ketë dhe një përshkrim të detajuar të vepres.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

Drejtuar Grupit te Punes

Në mbështetje të urdhërit të brendshëm të kryetarit të Bashkisë, Nr. Prot. 510, datë 19.01.2023
"Për përcaktimin e termave të referencës për objektin e prokurimit "Konkursi për Ideimin dhe Zbatimin e Vepres së Artit që do të vendoset në sheshin Europa Piazza, Fier"

Kemi bashkangjitur disa të dhëna shumë të rëndësishme për këtë projekt.

- 1.Ortofotot janë marrë nga ASIG (Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor)
- 2.Plani I Përgjithshëm Vendor (PPV).Ajo cka është akoma më e rëndësishme të dihet janë përdorimet së çfarë lejohet të ndërtohet dhe çfarë jo në këtë zonë.Dhe për këtë kemi ngarkuar pasaportën e kësaj zone me kodin 1/1 e cila është shkarkuar nga AKPT (Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit).
- 3.Planvendosja dhe gjendja ekzistuese .Kemi shkeputur fragment nga harta ekzistuese dhe me anë të programit AutoCad kemi sjellë një paraqitje të gjendjes ekzistuese së çfarë e rrethon këtë veprë dhe një planvendosje të rrethrotullimit ku do vendoset vepra.
- 4.Foto të sheshit Europa Piazza.

Keto të dhëna janë përpunuar prej dy përfaqësuesve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit që janë pjesë dhe e Grupit të punës për termat e referencës.

SHKIA 1

L


PLANI I PERGJITHSHEM VENDOR (PPV)


Pasaporta Nr. Kodi Plani I Emërtimi	1 1/1 Qendra, Zona e Masterplanit
Siperfaqe (m ²)	2240635
Perimeter (m)	1357.59
Perdorimi (K.Baze) ekz.	A.Banim, S.Sherbime, AR.Aktivitete sociale dhe rekreative, IN Infrastrukture
I (m ² /m ²)	0.73
KSHT (%) ekz.	23.33%
KSHR (%) ekz.	9.87%
KSHP (%) EKZ.	12.58%
Kapaciteti Mbajtes	2825
Numri I perdoruesve	E paaplikueshme
Perdorimi (K.Baze) prop.	A.Banim, S.Sherbime, AR.Aktivitete sociale dhe rekreative, IS.Institucione
% KATI 1	50
% KATI 2	30
% KATI 3	20
Perdorime te tjera te lejuara	Te gjitha ato qe nuk jane te ndaluara ose te kushtezuara
Perdorime te ndaluara	Industri dhe Ekonomi pervec magazinave me produkte jo ndotese, ushtarake, perdorime te vecanta dhe te gjitha ato qe nuk I sherbejne ose nuk perputhen me perdorimet e propozuara.
Perdorime te kushtezuara	Karburantet, me kusht qe te kene zone mbrojtje 60m perreth tyre.
Tipologjia	GJOB.KULA, Sh
Menyrat e nderhyrjes	Rizhvillim, Rikonceptim
Parcela minimale (m ²)	Sipas PDV
Distancat (m)	Sipas PDV
I max .lejuar (m ² /m ²) KAT1	5
I max .lejuar (m ² /m ²) KAT2	4
I max .lejuar (m ² /m ²) KAT3	
KSHT max. lejuar (%) KAT1	70%
KSHT max. lejuar (%) KAT2	70%
KSHT max. lejuar (%) KAT3	E paaplikueshme
KSHR min(%)	25%
KSHP min (%)	30%
Siperfaqe parkimi (m ²)	16952.82
Gjelberim (2.5m ² /banor)	7063.67
Gjelberim I pergjithshem (9m ² /banor)	25429.23

BASHKIA

PLANI I PERGJITHSHEM VENDOR (PPV)

I shtese me kushte (m ³ /m ³)	1
Lartesi max.(m) (jo l me kusht)	50
Lartesia max.(kate) (jo l me kusht)	15
PDV	Po
Sip.Min. per PDV (m ²)	8000
Plan rrugor para lejes	Jo
Instrumente zhvillimi	INK
Kushte per infrastrukturen, sherbimet publike e te tjera.	Njesia l nenshtrohet konkursit per zhvillim dhe dizenjim, sic parashikohet ne kete Rregullore; Madhesia minimale e zones per konkurs eshte sa siperfaqja minimale per PDV. Bashkia merr vendim per ndryshimin mes perqindjeve te secilit perdorim, ne varesi te tendencavete zhvillimit ne njesi. Ky ndryshim mund te jete deri ne 50% te vleres aktuale te propozuar.





ISHKIA



ΕΠΙΧΕΙΡΗΣΙΑΚΟ ΠΡΟΓΡΑΜΜΑ



СРБИЈА

7



10/10/2012



SHKIA

8



UNIP



UNIA S.A.

11

